



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **19.03.2019**, me fillim në ora **10.15**.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimi më lejoni të përshëndes, nënkyretarin **Fatmir Iska**, delegatët e pranishëm në këtë mbledhje të KPF-së, monitoruesit e OSBE-së, gazetarët, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Ky është takimi i tretë për vitin 2019, ju uroj të gjithëve suksese në punë. Kuorum për mbajtjen e mbledhje ka, Ju paraqes rendin e ditës të paraparë për këtë mbledhje:

REND DITE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i bartjes (rialokim) të të hyrave vetanake nga viti 2018 - 2019,
3. Shqyrtimi i Vendimit për dhëni e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër,
4. Shqyrtimi i Draft Rregullores për Realizimin e të Drejtave të Fëmijëve,
5. Shqyrtimi dhe marrja e Vendimit për dalje në debat publik të Draft Rregullores rrëth mënyrës dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës së sporteve "MIZAHIR ISMA" në Rahovec,
6. Informatë mbi menaxhimin e aseteve komunale të Komunës së Rahovecit,
7. Informatë nga Komiteti për Auditim të Brendshëm të Komunës së Rahovecit,
8. Informatë mbi Raportin final të auditimit të brendshëm të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit për vitin 2018,
9. Informatë mbi menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimërorë,
10. Të ndryshme.

Kryesuesi – E qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës: Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e kaluar.

Kryesuesi - A ka dikush të shtoj diçka rrëth procesverbalit, nëse nuk ka atëherë e qes në votim Procesverbalin nga Mbledhja e Kaluar: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë (1) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

2. Shqyrtimi i bartjes (rialokim) të të hyrave vetanake nga viti 2018 – 2019.

Afrim Limani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, siç e dini ju kjo është një rregull e përcaktuar me ligj, ku për çdo vit bëhet bartja e të hyrave vetanake nga viti i kaluar në vitin pasues. Totali i të hyrave të komunës së Rahovecit për vitin 2018 është 403,221.00 €, ne në bazë të disa analizave të gjithanshme këtë

shumë e kemi bartur në disa projekte të cilat janë më me prioritet. Prioritet i kemi dhënë disa projekteve që janë në përbyllje dhe mbulimin e një pjese të borxheve që e kemi më shumë në disa projekte. Shuma prej 160,807.00 € e kemi bartur në projektin e ndërtimit të rrugëve me kubëza në Dobidol, Polluzhë, Ratkoc, Gexhë dhe Kramovik, ne kemi qenë të detyruar ta bartim këtë shumë sepse operatori në fjalë e ka dërguar lëndën në thesar dhe ne kemi qenë të detyruar me e bërë pagesën ka muaji shkurt, por në këtë kohë nuk kemi pasur mjete. Ne e kemi lutur departamentin e thesarit që të mos e marrin këto mjete sepse ne kemi mjete dhe kur të bëhet bartja e mjeteve do ja bëjmë pagesën, ata na kanë mirëkuptuar prandaj ne jemi të detyruar që këtë shumë ta mbulojmë për këtë projekt. Pjesën tjetër të mjeteve e kemi bartur në intervenime emergjente në infrastrukturë me shumën prej 32,977.00 €, shuma tjetër ka shkuar për projektin Rregullimi i shtretërve, lumenjve dhe prockave në Komunën e Rahovecit, ku kemi një kontratë të madhe me shumën prej 765,000.00 €, ku ne i kemi bartur 38,000.00 €, pastaj projekt i ndërtimit të shkollës në fshatrat Hoçë e Vogël dhe Brestoc, një kontratë me shumën prej 464,000.00 €, ne në këtë projekt i kemi bartur 69,000.00 €, projekt tjetër është ndërtimi i çerdhes në fshatin Ratkoc, kontrata është në shumën prej 468,000.00 €, ne këtu i kemi bartur 65,000.00 € dhe projekt i fundit është kullimi i tokave bujqësore në fshatin Xërxe ku i kemi bartur 15,000.00 €. Po ashtu i kemi bartur shumën prej 21,926.00 € në pozicionin e pagave në kuadër të drejtorisë për shëndetësi, kjo është e rregulluar me ligj dhe ne jemi të detyruar që ti bartim sepse vitin e kaluar ne i kemi bartur të hyrat vetanake, por Drejtoria e Shëndetësisë nuk i ka shfrytëzuar këto mjete dhe ne në raporte me ligjin duhet që ti derdhim këto mjete. Desha të ju bëjë një kërkësë juve të nderuar kuvendarë, pas dorëzimit të këtij materiali, drejtorisë së shërbimeve publike i kanë ardhur kërkesa të shumta nga qytetarët për ndërtimin e rrugëve lokale. Ne së bashku me Drejtoren e Shërbimeve Publike kemi menduar nëse edhe ju jeni të pajtimit ta hapim edhe një kod dhe në mbledhjen e radhës të kuvendit të jetë si pikë e rendit të ditës, injetet të merren nga këto projekte nga pa ashtu siç propozoni ju dhe të jetë një kod deri në 5,000.00 €, por gjithmonë e them nëse jeni të pajtimit edhe ju.

Rasim Fazliu – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, nevojat janë të ndryshme në komunën tonë, prandaj mendoj se kemi ku të i qojmë këto mjete, mendoj se edhe jashtë këtyre projekteve që i ka paraparë qeverisja komunale, por meqenëse këta vetë kanë me u marrë me pagesa atëherë mendoj se këta e dinë më së miri se ku duhet të shkojnë këto mjete. Por ajo që dua ta pyes drejtoren është se këto projekte a janë të përfunduara krejtësisht dhe tanë kanë mbetur vetëm të kryhen obligimet, apo ka nga ta që janë ende në punim e sipër. Vendimin të cilin na e sollët tanë tek kategoria e pagave dhe mëditjeve shuma prej 21,926.00 €, çka do të thotë kjo sepse për investime kapitale dihet shuma prej 381,295.00 €: Përndryshe edhe unë jam për ato që aty ku është më e nevojshme dhe më emergjente të i bartim këto mjete, në mënyrë që të shkojë puna sa më mirë.

Fehmi Cena – Përshtendetje për të gjithë të pranishmit, Fillimi isht falënderoj Drejtoren për Financa që na ka prezantuar këtë gjendje të buxhetit të mbetur nga viti paraprak, desha të i sqaroj disa gjëra që janë këtu në tabelë. Këtu janë të cekur tre shtyllat e fundit, pagesa sipas dosjes është pjesa e mjeteve që është paguar për këto projekte, pastaj shtylla e parafundit është borxhi sipas kontratës është pjesa e pa paguar, kurse shtylla e fundit bartja e mjeteve është pjesa e mjeteve në dispozicion që ka qenë dhe së është dhe kërkohet të bëhet rialokimi i tyre. Pyetje ime është: Pse nuk janë paguar këto mjete gjatë viti 2018, por ka mbete me u mare për vitin 2019, duke e ditur se edhe kështu ka shumë pagesa për tu bërë. Pjesa tek pagat dhe mëditjet drejtori e ceku se kjo shumë ka mbetur nga Drejtoria për shëndetësi, pikërisht nga pozicioni i pagave dhe mëditjeve, pyetje ime është: A kemi ne të drejtë me i bartë këto mjete, pra komuna me i shfrytëzu këto mjete nga paga dhe mëditjet, sa e di unë kjo shumë nga pagat dhe mëditjet shkon në suficit. Po ashtu nëse mundet të bëhet ky rialokim kërkesa ime është që këto mjete të shkojnë përsëri për Drejtoren e Shëndetësisë, qoftë në paga dhe mëditje qoftë në destinacionet e tjera që kanë të bëjnë me drejtoren e shëndetësisë sepse me të vërtet ka shumë nevojë.

Afrim Limani – I nderuar z. Rasim Fazliu, ne këtu i kemi mare për bazë borxhet financiare që janë bartur nga viti i kaluar, pra kryesisht janë borxhe financiare që operatorët i kanë dorëzuar faturat në zyrat tona por ne nuk kemi mundur të i paguajmë. Disa projekte janë ende në proces të vazhdimit, por ne këto mjete i kemi ndarë për pjesën e punëve që i ka kryer operatori dhe e ka dorëzuar faturën financiare. Pagesa prej 21,000.00 € në pozicionin e pagave është në drejtoren e shëndetësisë, ne vitin e kaluar i kemi ndarë këto mjete por për arsyet e ndryshme nuk janë shfrytëzuar, prandaj me ligj jemi të obliguar që të derdhim përsëri në kuadër të

këtij pozicioni, këto mjete janë nga të hyrat vetanake dhe mjetet nga të hyrat vetanake nuk shkojnë në suficit. I nderuari Fehmi Cena bëri pyetje pse për projektin e ndërtimit të shkollave në Hoçë dhe Brestoc dhe ndërtimi i çerdhes në Ratkoc nuk është bërë asnjë pjesë e pagesës. I nderuar kontrata për këto dy projekte është lidhur diku ka fundi i viti të kaluar, operatori në atë kohë nuk ka mundur të kryej punë që të dorëzoj pastaj ndonjë faturë tek ne, por e mirë e kësaj është se këto mjete që janë dedikuar për këto projekte nuk janë shkuar në suficit, por kanë qenë të planifikuara nga të hyrat vetanake.

Rasim Fazliu – Sa i përket propozimit që na e dha drejtori për hapje të një kodi të ri për ndërtimin e rrugëve në komunën e Rahovecit me një shumë prej 5,000.00 €, ne nuk ka shumë kohë që e kemi pasur miratimin e buxhetit për vitin 2019, mendoj se aty janë paraparë të gjitha gjërat, po ashtu edhe rregullimi i rrugëve është paraparë në buxhetin e viti 2019 është një kod. Mendoj se në suazën e atij buxheti që ne e kemi aprovuar mundemi me i krye punët, por nëse mendoni të hapni një kos simbolikisht me shumën që e propozuat prej 5,000.00 € dhe pastaj të thithet ndonjë burim tjetër, ose keni ndonjë zotim nga qeveria qendrore atëherë na informoni dhe do ta diskutojmë. Por siç e thash ne një buxhet e kemi aprovuar dhe aty janë të paraparë të gjitha ato që i kemi pas ndërmend të i realizojmë për vitin 2019.

Fehmi Cena – Edhe unë nuk jam duke parë ndonjë arsyet që fortë që ne të bëjmë ndonjë ndryshim nga këto pozicione, të gjitha këto kategori të projekt edhe ashtu janë, kanë kaluar në aprovim të buxhetit të vitit 2019. Po ashtu me një shumë prej 5,000.00 € nuk është se mundet të bëhet ndonjë projekt i veçantë, pastaj nëse drejtori kërkon që të merret një shumë prej 5,000.00 € nga projekti i rregullimit të shtretërve lumenjve dhe prockave, ne jemi duke parë që borxhi edhe ashtu është shumë i madh në këtë projekt, prandaj mendoj se nuk është mirë të merren nga ky projekt. Por nëse drejtoria e ka ndonjë projekt me emër dhe mbiemër dhe mendon se është me rëndësi atëherë ajo mundet të propozoj në mbledhjen e ardhshme të kuvendit, pastaj ne do ta shqyrtojmë se cili është ai projekt dhe a ja vlen që ti bëjmë këto transferime.

Dervish Çadraku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, mendoj se gjatë punëve që bëhen në komunë dalin edhe të papriturat për të cilat duhet ndoshta shpesh herë edhe të bisedohet dhe bashkëpunohet, në mënyrë që të tejkalohen këto vështirësi që na dalin. Prandaj mendoj se shuma që është duke u kërkuar prej 5,000.00 € në mënyrë që të hapet një kod i ri, jam pro këtij propozimi sepse mendoj se është mirë, por unë kam edhe një kusht, nëse hapet ky kod le ta mbulon edhe ndërtimin e parkingjeve të reja. pjesa ku ka qenë ish gjimnazi i vjetër përball policisë me 2-3 mijë euro mendoj se mundet të rregullohet përfillim, pra të shtrohet vetëm me zhavorr, aty mendoj se do të bëhet një hapësirë e mjaftueshme përfi parkuar makinat. Është mese e domosdoshme ky parking sepse në këtë pjesë është komuna, gjykata, policia dhe njerëzit nuk anë ku ti parkojnë makinat.

Kryesuesi – E qes në votim propozimin e Drejtorit të Financave që ta hapet edhe një kod për ndërtimin e rrugëve të komunës së Rahovecit: Konstatoj se me 3 (tre) vota përfi dhe 4 (katër) vota kundër, nuk kalon propozimi i Drejtorit të Financave. Tani e qes në votim pikën e 2 (dytë) të rendit të ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 2 (dytë) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Vendimit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër.

Artan Asllani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne si drejtori e kemi një propozim për dhënien në shfrytëzim të pronës në fshatin Xërxe është një objekt në hyrje të depove, ky objekt është në gjendje jo të mirë ne e kemi parë të arsyeshme të kem si propozim në kuvenden komunal të jetë objekt në shfrytëzim, është një hapësirë prej 187 metra katror në bazë të certifikatës i keni të dhënët. Qëllimi i dhëniec në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës është e cekur në pikën 1 dhe 2 është ruajta dhe rritja e vlerës së pronës komunale. Zhvillimi i aktiviteteve të bizneseve për zyrat administrative të cilat do të lehtësojnë ushtrimin e veprimtarisë bizneseve, dhe dhënien e mundësisë tek qytetarët përfi vetë mësim. Kryesisht afati kohor përfi dhënien me shfrytëzim të këtyre objekteve e kemi parë të arsyeshme të jetë përfi 5 vite, ndërsa përfi procedura ankand publik do të kujdeset drejtoria përfi ekonomi dhe e kadastrës do të shkoj nëpërfi mjetë procedurave të ankandit të hapur.

Rasim Fazliu – Sa i përket kësaj pike e falënderoj drejtorin përfi prezantim është e qëlluar që ai objekt të mos rri i zbrazët dhe të shkatërrohet përfi shfrytëzohet prej dikujt sepse sjellë vetëm të mira materiale, unë dua të

di a ka shfaqur dikush interesim për këtë objekt paraprakisht sepse unë e di që duhet ti nën shtrohet ankandit publik, ne jemi në mbledhjen e KPF-së dhe këtu na ka ardhur vendimi që zakonisht duhet për mbledhje të kuvendit, kurse këtu duhet të vijë Propozim vendimi. Këtu kemi pak sh' përputhje për propozim vendimin ku shkruhet që merret vendim paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim të personave fizik dhe juridik, dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik të dhënes në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 deri në 15 vite, ndërsa këtu tek propozimi është për 5 vite, mirë ju që e keni propozuar, por gjithmonë duhet të respektohen procedurat e ankandit publik dhe kuvendi është ai që gjithmonë vendos dhe ne jemi ata që vendosim se për sa vite të jepet objekti në shfrytëzim.

Fehmi Cena – Unë mendoj që këto raste kur tentohet nga drejtoria përkatëse apo drejtori të tjera të jepet në shfrytëzim prona e paluajtshme komunale person fizik dhe juridik, mendoj se është e dobishme dhe duhet të jemi pro kësaj sepse e ka dobinë e vetë për komunën por edhe për biznese dhe qytetarët tanë. Pra në këtë rast ne pajtohem që kjo të kaloj në kuvend, këtu ceket qëllimi por mendoj se edhe destinim duhet të ceket, kur dihet direkt për ndonjë pronë të paluajtshme komunale që do të jepet qoftë parcelë apo objekt le të shkruhet edhe destinimi, nëse nuk ka destinim atëherë qëllimi le të mbetet. E kam vërejtur edhe një gabim në shifra në këtë vendim për kuvend dhe propozim vendimin për KPF, tek vendim për kuvend pika e dytë 2.2 mendoj se është gabim kjo 2767 metra katror nuk përputhet me atë të përgjithshme 7997 metra katror, përderisa tek propozimi që na ka ardhur për KPF përputhet pra është një 1491 metra katror. Propozoj që kjo të rregullohet për mbledhje të kuvendit.

Kryesuesi – Ju faleminderit për diskutimin e bërrë rreth pikës së tretë (3), qes në votim Vendimin për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër për pesë (5) vite, konstatoj se unanimisht aprovohet pika e tretë (3) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e 4 të rendit të ditës

4. Shqyrtimi i Draft Rregullores për Realizimin e të Drejtave të Fëmijëve.

Isak Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, është hera e dytë që vie në kuvend kjo rregullore, dje ka përfunduar debati publik në orë 13:30 nuk ka pasur ndonjë ndryshim, plotësim apo sugjerim i ka kaluar të gjitha procedura të cilat duhet ti ketë një rregullore, e kemi planifikuar të jetë në rend të ditës që mos të humbim kohë prej 15 ditë, ndonjë plotësim tjetër mund të bëjmë gjatë rrugës për në kuvend ne mund ti rikuperojmë në rregullore në mënyrë që të del sa ma e kompletuar.

Florinda Bajraktari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, këtë rregullore e kam lexuar me vëmendje dhe konsideroj që është gjithëpërfshirëse, është mirë që për herë të parë po e miratojmë një rregullore për të drejta e fëmijëve mendoj që duhet të përcillet për kuvend dhe të miratohet.

Kryesuesi – Ju faleminderit, e qes në votim Draft Rregulloren për Realizimin e të Drejtave të Fëmijëve: Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e katërt (4) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

5. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për dalje në debat publik të draft rregullores rreth mënyrës dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës së sporteve MEZAHIR ISMA në Rahovec.

Isak Hoti – Pas kërkësës për hartimin e Draft Rregullores për Mënyrën e Kushteve dhe Shfrytëzimin e Palestrës Sportive MEZAHIR ISMA, zyra ligjore ka filluar draftimin e rregullores në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport me të cilën kemi mbledhur dhe akter kyç në Drejtori për Financa. Ku kemi pasur një takim të përbashkët në Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport dhe zyra ligjore ku i kemi marr praktikat dhe draftë nga komuna tjera dhe jemi munduar ti harmonizojmë me specifikat e komunës sonë. Paraprakisht i kemi vendos disa tarifa ku mund të shtohen, thjeshtë bashkë duhet të mobilizohemi dhe të bëjmë një rregullore të mirë të përbashkët që të krijojmë të hyra nga palestra sportive njëkohësisht të krijojmë kushte për sportdashësit. Rregullorja i ka gjithsej 17 nene këtu përfshihet rregullimi dhe ndryshimi i mjedisit, pagesat për shfrytëzimin e objekteve në palestër.

Rasim Fazliu – Fillimi shqiptar i kënaqur dhe i lumtur që në komunën tonë tash më e kemi një palestër ku të rinjtë tanë mund ti zhvillojnë aktivitetet e tyre sportive, është një punë shumë e mirë kjo e falënderoj zyrtarin që e ka sjellë këtë draft rregullore. Sigurisht që gjatë rrugëtimit do të plotësohet dhe pastaj pas kthimit në kuvend do ta shqyrtojmë dhe do ta aprovojmë. Mbështetje praktikave të komunave tjera palestrat sportive a menaxhohen nga komuna apo jepen që të mbikëqyren nga dikush tjetër, është mirë të mendohet qysh tani se cila mënyrë është më e mirë përmirësuar, sepse luan rol të madh dhe gjithsesi përmirësuar që do ti sjellë sepse është interes i yni. Në mbledhjen e kuvendit do të diskutojmë me tepër dhe do të japid kontributin tonë.

Fehmi Cena – Mendoj se është bërë një punë e mirë me Rregullore përmirësuar Shfrytëzimin e Palestrës MIZAHLIR ISMA në Rahovec, natyrisht të gjithë jemi gjuar kësaj palestre sportive sepse ka qenë shumë e nevojshme përmirësuar. Tani po bëhet edhe kjo rregullore unë mendoj se duhet të kaloj në kuvend ku do të jetë një debat më i gjerë ku kemi ekspert të sportit në mënyrë që kjo rregullore të plotësohet dhe të jetë më funksionale në komunën tonë.

Kryesuesi - Ju falënderoj përmirësuar diskutimin e bërë rreth pikës së pestë (5), e qes në votim Vendimin përmirësuar dalje në debat publik të draft rregullores rreth mënyrës dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës së sporteve MEZAHLIR ISMA në Rahovec: Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e pestë (5) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

6. Informatë mbi menaxhimin e aseteve komunale në komunën e Rahovecit.

Artan Asllani – Siç e dini komuna e Rahovecit ka pasur një problem të kahershëm në menaxhimin e aseteve komunale, me rekomandim të zyrës së auditorit kombëtar përmirësuar vitin 2017 dhe rekomandimeve të vazhdueshme përmirësuar vitin 2018 si problem ka qenë regjistrimi i aseteve komunale, me propozim të drejtorisë së ekonomisë iu kemi drejtuar kryetarit të komunës z. Smajl Latifi të cilit i kemi propozuar ngritjen e disa komisioneve që merren me regjistrimin e pasurive jo financiare. Në vazhdim ju kam paraqitur në mënyrë tabelare përshkrimin artikuj dhe vlerën. Inventari në administratë në vitin 2018 ishte rreth 4472 artikuj dhe vlera e këtyre aseteve jo financiare ishte 128,384.00 €, po ashtu është edhe inventari nëpër shkolla e komunës së Rahovecit ishte 19.764 artikuj dhe vlera e të gjitha këtyre aseteve ishte rreth 287,797.40 €, po ashtu inventari i QKMF-së, AMF-ve, ku në total komplet përmirësuar vitin 2018 vlera e këtyre aseteve financiare është 470,115.40 €. Dua të ndalem në këtë pikë pasi që tërë këto artikuj dhe vlera është shumë e vogël në mjete monetare, në kuvendin komunal ka mjaftë asete në të gjitha institucionet që komisioni kur e bën vlerësimin e bën me anë të katalogut, dhe ne në momenti që bëhet blerja tek jo vlera financiare shkon deri në 20% vlera e amortizimit të pajisjeve, mjeteve dhe gjë sendeve tjera, ku vlera e tyre shkon deri në 5% vlera e amortizimit, në bazë të konstatimit të komisionit vlera reale është 470,115.40 €, ndërsa gjatë viti jemi përkujdesur që pasi kemi bërë regjistrimin dhe vlerësimin e kemi një sistem të posaçëm prej ministrisë së financave e kemi obligim që këto asete ti vendosim nëpër programë që quhet E-Pasuria, është program i veçantë që kemi bërë dalje të të gjitha këtyre aseteve që janë edhe barkode që janë shpërndarë përmirësuar. Në bazë të numrit të barkodit auditorët të jashtëm apo të brendshëm nëse shprehin interes mund të bëjnë verifikimin e artikullit. Gjatë vitit 2018 kemi pasur rekomandim të kahershëm nga auditori i jashtëm regjistrimin e tokave në komunën e Rahovecit, vite më parë kanë punuar misione të ndryshme por nuk kanë arritur të bëjnë regjistrimin e komplet tokave bujqësore. Ne gjatë vitit 2018 kemi punuar pa ndalur ku kemi arritur regjistrimin e 460 parcela të tokave me vlerë prej 16 milion euro, por e kemi bërë në mënyrë tabelare komplet asete përmirësuar vitin 2018. Në objekte arsimore e kap një vlerë prej 14.106.042.53 € në objekte sportive, vutura, objekte shëndetësore d.m.th deri më 31 dhjetor 2018 komplet pasuria e komunës së Rahovecit e kap një vlerë 81.807.030,30 €.

Fehmi Cena – Drejtori e ceku që ende ka punë në pasurinë e paluhatshme në toka ashtu është mbetur të kuptohet 81.807.030,30 € nuk është finale sepse kur regjistrohen pjesë tjera do të jetë shtesë, kjo nuk është e gjitha në qoftë se kjo është e gjitha dua të qartësoj.

Artan Asllani – Sa i përket tokave ne nuk kemi arritur të bëjmë regjistrimin e tyre pasi që kemi pasur të bëjmë me auditor të jashtëm dhe janë të kënaqur me punën që e kemi bërë, sidomos me astetet jo financiare, mirëpo e kemi edhe një zbutje tek asetet e paluajtshme të tokave, kryesisht tokat nuk janë përfunduar pasi që ka shumë parcela ne jemi përkujdesur në drejtori të gjeodezisë i kemi marr pikat ku janë tokat, normalisht kemi shumë punë sepse duhet të shikojmë dhe vlerësojmë trotuaret, asfaltet, varreza dhe tokat tjera nuk kemi arritur ti përfundojmë të gjitha, por shpresoj deri më 6 muajt e parë të këtij viti do të përfundojnë të gjitha regjistrimet.

Rasim Fazliu - E falënderoj drejtorin Artan Asllani për këtë informatë, është mirë që janë formuar këto komisione dhe kanë kryer një punë të madhe, se e dimë që ndër vite nga auditori kombëtar kemi pasur vërejtje gjithmonë në këtë drejtim që nuk janë të regjistruar asetet e komunës, edhe njëherë e përgëzoj për punën dhe gjitha angazhimet për pasurit nën 1,000.00 € dhe mbi 1,000.00 €. Çfarë kritere ka përdorur komisioni për vlerësimin e pasurive të patundshme qoftë objekteve apo tokave? Duke e ditur se kemi objekte të reja dhe të vjetra d.m.th cili ishte kriteri që është përdor për vlerësimin e këtyre pasurive.

Artan Asllani – Kriteri kryesor ka qenë tek komisioni që ne jemi kujdesur që në këtë komision të jetë një ekonomist, një jurist dhe një gjeodet, pra një komision sa më profesional sa i përket vlerësimit lidhemi kryesisht tek objekte nëse ndahet në kategori të rrugës ku vlera e një lokali kah rruga A me pas një vlerë më të madhe, sikur me një fshatë tjetër me qenë objekt i komunës ose nëse është më i vjetër më i shkatërruar nuk mund të këtë vlerën e njëjtë si të një objekti të rri, komisioni e ka vlerësuar në vendin e ngjarjes dhe e kanë konstatuar vlerën e atij objekti, ndërsa tek kriteret e tokës varret se ku gjendet toka a është afér rrugës, a është e shtruar rruga me asfalt dhe varet nga hapësira dhe çmimi real dhe varet nga cilësia e tokës.

Kryesuesi – Ju faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë për pikën e gjashtë (6) të rendit të ditës, kalojë në pikën e radhës:

7. Informatë nga komiteti për auditim të brendshëm të komunës së Rahovecit.

Afrim Limani – Në bazë të të gjeturat të auditorëve dhe në bazë të rekondimeve të auditorit kombëtar ndër vite që ka figuruar mos funksionimi i Komitetit të Auditimit ne këtë vit kemi arritur të formojmë komitetin që të kryej punën e vetë siç duhet, ku gjatë vitit 2018 kemi mbajtur tri seanca, i keni të gjitha procesverbale se çka është diskutuar aty, kemi arritur që çdo raport të përgatitur nga ana e auditorit të brendshëm ku është shqyrtuar gjithçka, janë bërë analiza, rekondime dhe sugjerime. Në atë mbledhje përpos Komitetit të Auditimit kanë qenë prezent të gjithë zyrtar auditues, drejtori i drejtorisë auditorë dhe drejtor i financave i kemi verifikuar bashkërisht, dhe ju siguroj që ky komitet ka dhënë efektin e vet dhe ka ndikuar që në pasqyrën financiare të komunës së Rahovecit të përgatiten sa më mirë, gjithashu efekti dhe qëllimi i kësaj është arritur. E keni një material para vetës ku jemi munduar ti fusim të gjitha të dhëna gjithëpërfshirëse që ti keni informata të mjaftueshme. Auditori kombëtar i ka bërë auditimin e pasqyrës financiare të komunës së Rahovecit ku është vlerësuar me notë pozitive, kemi marr një këshill nga auditimi tek formimi i komitetit të ri për vitin 2018 që në këtë komitet të përfshihen njerëzit të cilët nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë në financa.

Florida Bajraktari – Faleminderit kryesues, unë e kam lexuar dhe analizuar materialin dhe desha ti bëj një pyetje anëtarëve të këtij komitetit ose drejtorit të financave, këto aktivitete që janë kryer rrëth punëve të auditimit të brendshëm për cilin vite janë kryer?

Afrim Limani - Në fakt këtë material është dashur që ta prezantoj kryesuesi i komitetit, por unë si drejtor isha prezent vazhdimisht dhe konsideroj që kam dhënë kontribut, komiteti i auditimit gjithmonë i ka audituar raportet e auditimit të brendshëm brenda vitit 2018, gjithashtu i ka bërë pasqyrimet e viti 2017.

Binak Kryeziu – Auditimi i brendshëm është bërë për vitin 2018 bashkë me planin strategik, në planin vjetor parashihen auditimet me rend tash e kemi një auditim që është numër një (1), që është bërë në muajin e dytë fushëveprimi ka qenë në muajin e dytë për këtë arsy e kemi vetëm për dy muaj të vitit 2018, kurse 6 muaj për 2017 i kemi përfshirë pasi që vazhdon aty ku ka mbetur, tanë për vitin 2019 vazhdon prej muajit shkurt aty ku kanë mbet.

Rasim Fazliu - E përgëzoj formimin e Komitetit të Auditimit sepse këtu gjithmonë kemi pasur vërejtje prej auditorit kombëtar përsë nuk funksionon ky komitetit i auditimit, unë e kam pritur shumë mirë formimin e komitetit, mirëpo të them të drejtën e kam analizuar dhe shqyrta këtë material jam i zhgënjer me punën që e ka bërë komiteti, ai e ka harxhuan energjinë kot. Për qeverisjen që shkoi nuk ka pse të harxhoj energjinë pasi që ajo punë është përfunduar dhe nuk janë prezent ata njerëz që të kërkojmë llogari. Më vjen mirë që e kemi këtu drejtorin e auditimit të brendshëm, mirëpo unë konsideroj që auditori dhe komiteti i auditimit është dashur të merren me auditimin e vitit 2018 dhe të shohim se çfarë përmirësimi ka bërë kjo qeverisje komunale. Jemi në vitin e dytë të qeverisjes dhe është mirë të shohim ndryshimet pozitive a janë bërë karshi qeverisjeve tjera që kanë qenë deri tanë.

Fehmi Cena – Kisha dashur që ti sqarojmë disa gjëra që në kuwend ti kemi më të qarta, mirëpo është përtu ardhur keq pasi që nuk është prezent kryetari i komiteti për auditim, unë mendoj që ky rapport është mjastë gjithëpërfshirës por ka edhe gjëra të pa qarta, ndoshta ka ndikuar mënyra e përpilimit, unë e kuptoj që ky rapport i takon vitit 2017 edhe pse këtu ceket viti 2018, por këto shënimë dalin se i takojnë vitit 2017. Sa i përket rëndësise së auditimit unë e kam shprehur mendimin edhe më herët se auditimet gjithmonë janë të mirëseardhura nga kush do që bëhen, edhe nga ky komitet sepse për këtë është formuar. Gjithmonë tek auditimet vërehet a është punuar mirë apo jo, cilat janë të gjeturat të rregullta apo të pa rregullta, pastaj auditimi ka dhe rekomandime që i bëjnë organet e caktuara që të përmirësohen ku kanë gabuar qoftë qëllimi apo jo, pra auditimi gjithmonë i shërbën për një punë sa më të mirë në të ardhmen. Desha të sqaroj p.sh buxheti final i cili është prezantuar gabimisht, ceket këtu nën vlerësimi i buxhetit të komunës në vlerë prej 437,000.00 € i takojnë vitit 2017, çfarë gabimi është nëse është prezantuar? Një sqarim pasi në mbledhjen e ardhshme do të keni më të vështirë përtë sqaruar më mirë tanë, pasi që ne i njoftojmë grupet tona asamblistë më mirë, çka është puna e kësaj shume pasi që ceket në procesverbale dhe raport. Pikërisht drejtori i tanishëm Afrim Limani që ka marr pjesë aty, ato kriteret e rëndësishme që merren për një komunë ceket aty pasqyra financiare e kualifikuar pozitivisht nga ana e auditorit është shumë faktor me rëndësi për donacione dhe grante qeveritare edhe realizimi i buxhetit mbi masë 75%, neve na ndihmon kjo shumë që ta kupojmë edhe politikën e financave si këshilltar. Por kjo shumë çka është pasi përfshin 20% të buxhetit komunal, pastaj mund të këtë peshë në ato kritere, e kemi vërejtur që diku ka pasur përparime p.sh tek taksa për shfrytëzim të përkohshëm në hapësira publike, rritje të inkasimit, rrënje të inkasimit, taksa e vendosjes së objekteve të përkohshme, baraka, kioska, kur jemi tek baraka, kioska janë disa ndërtesa për banime kolektive kanë baraka dhe unë kam dëgjuar nga disa qytetar që është marr një vendim tek ndërtesa poshtë nën semaforë të hiqen garazhet, po flitet në opinion nuk e di a është një vendim i tillë apo jo. Pastaj tek mbeturina gjithashtu ka pasur paqartësi në diskutim të komitetit për auditim një shumë prej 400,000.00 € është paraparë por nuk është realizuara, por është realizuar një shumë më e vogël, ndërsa ne e kemi paraparë për këtë vit nga menaxhimi i mbeturinave 191,000.00 €, është edhe këtu diku e cekur që do të këtë më pak të hyra nga sugjerimet e drejtorit, mirëpo më intereson për vitin 2019 menaxhimi a do të hyjë ajo formë që e

kemi diskutuar nëpërmjet komunës, a është duke u punuar, edhe neve na është thënë në kuvend se është duke u punuar me një delegacion të Japonisë disa eksperët që janë duke u munduar të bëjnë pilot projekte si në Prizren, a do të bëhet në komunën tonë apo do të mbetet siç ka qenë deri më tanë.

Afrim Limani – Detyra dhe puna e Komitetit të Auditimit është shqyrtimi i raporteve të kaluara nga ana e auditorit kombëtar dhe auditorit të brendshëm. Komiteti i auditimit e ka bërë shqyrtimin e raportit të zyrës së auditimit kombëtar, fillimisht në seanca e parë e kemi shqyrtuar në cilësinë e drejtorit të financave edhe pse nuk e kam pasur obligim por kam marr pjesë dhe e kam dhënë kontributin. Komiteti i auditimit gjithmonë merret me shqyrtimin e raporteve të auditorit, rast konkret të auditorit të jashtëm dhe auditorit të brendshëm. Ne gjatë vitit 2018 kemi arritur të shqyrtojmë të gjitha raportet që i kanë nxjerr auditor p.sh në momenti që ka dal rapporti nga auditori i brendshëm ne e kemi mbajtur seancën e rrallës, ka pasur raste kur i kemi shqyrtuar dy raporte të brendshme dhe e kemi dhënë pjesën tonë të kontributit. Sa i përket çështjes së mbeturinave ne e kemi diskutuar gjatë shqyrtimit dhe kemi pasur seancë të rregullt që të shqyrtojmë raportin e auditorit kombëtar të vitit 2017, çështja e mbeturinave është diskutuar shumë, kemi dhënë pjesën e kontributit edhe pse akoma nuk e kemi në raport jemi duke e pritur në fund të muajit prill tek zyra kombëtare e auditimit për pasqyrë financiare të komunës së Rahovecit për vitin 2018. Unë kam pasur diskutime në lidhje me këtë çështje me auditor kombëtar dhe do të figuroj si e gjetur edhe gjatë vitit 2018, mirëpo tek çështja e mbeturinave dhe inkasantëve asnjë komunë në Kosovë nuk ka arritur në përjashtim të Prizrenit, në këtë vit i kemi marr disa instrukSIONE, para përgatitjet besoj dhe shpresoj që shumë shpejtë do të bartim edhe përvojën e Prizrenit me ndihmën e Japonezëve. Tek tatimi në pronë, mbeturinat limitet i caktuan ministria e financave, ne duhet të realizojmë, sa i përket mbeturinave kam biseduar dhe kam këruar pasi që është viti i parë të zbritet, vitin e kaluar ne kemi këruar me 450.000 euro, kjo është gjendja dhe shpresoj që shumë shpejtë do ta bartim përvojën e Prizrenit.

Kryesuesi – Faleminderit për diskutimin e bërë rrëth pikës së shtatë (7), kalojmë në pikën e radhës.

8. Informatë mbi reportin final të auditimit të brendshëm të drejtorisë për Urbanizëm, planifikimi hapësinor dhe mbrojtje të mjedisit për vitin 2018.

Binak Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë, njësia e auditimit të brendshëm do të ju jep një informatë të shkurtër për reportin final të auditimit të brendshëm në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit. Në bazë të planit vjetor është kryer auditimi i brendshëm në drejtori në periudhën kohore prej 15 dite, sepse plani vjetor na ka imponuar që ti auditojmë në fillim të vitit, por në qoftë se i lëmë raportet pas 6 muajve ti auditojmë për vitin aktual nuk do të arrijmë që ti auditojmë të gjitha pasi që janë 11 auditime mbase planit vjetor. Kështu që aty ku mbetet viti 2019 prej muajit shkurt deri në muajin dhjetor të vitit 2018.

Kryesuesi - Faleminderit për diskutimin e bërë rrëth pikës së tetë (8), kalojmë në pikën e radhës.

9. Informatë mbi menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimërorë.

Nënkryetari – Përshëndes gjithë të pranishmit, është një informatë e detajuar e tenderit të ndarë në dy loto, paraqet vlerën dhe kompanitë të cilat e kanë mirëmbajtur dhe menaxhuar situatën gjatë sezonit të dimrit, nuk kam çka të shkoj më tepër nëse keni ndonjë pyetje, jam këtu për tu ju përgjigjur.

Fehmi Cena – Desha vetëm një sqarim, thuhet se janë dy kompani por këtu janë tri emra me një kompani, në loton e dytë janë dy kompani, d.m.th janë tri kompani të ndarë në dy loto.

Kryesuesi – Ju faleminderit, kalojmë në pikën e fundit për këtë mbledhje:

10. Të ndryshme

Fjolla Duraku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, dua të flas rreth gabimëve drejtshkrimore që janë duke u bërë në dokumente zyrtare, të gjitha dokumentet që neve na servohen thaujse kanë gabime në secilën fjali, besoj që secilit person që i lexon do i bije në sy. Dua të lidhem me mbledhjen e kaluar që u tha se duhet të ketë student të cilët duhet të kryejnë praktik në komunën tonë, besoj që është e mirë dhe e nevojshme për të dyja palë të marrim student gjuhësie që të bëjnë praktik këtu dhe në secilën dikaster të komunës së Rahovecit..

Kryesuesi – Unë e kam një kërkesë që në mbledhjen e rregullt të kemi edhe një pikë shtesë nëse edhe ju pajtoheni. Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre që është nga drejtoria për gjeodezi dhe kadastër. Kjo pikë është anuluar me kërkesë të kuvendarëve. Nëse nuk ka askush të shqiptarë që i përket pikës së fundit, mua më mbetet të ju falënderoj për kontributin e dhënë sot, shihemi në takimet e radhës.

Mbledhja ka përfunduar në ora: 12:20

Procesmbajtësi,
Skender Hamza

